



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Shtator 2022

Lançohet nisma për përditësimin e Ligjit të Dhomave të Tregtisë. Në fokus, përmirësimi i klimës së biznesit në vend.



Kjo nismë synon përmirësimin e indikatorëve cilësorë dhe sasiorë në raportet ndërkombëtare, zhvillimit ekonomik dhe bashkëpunimit të ndërsjellë për ta kthyer Shqipërinë jo vetëm në një vend përthithës të investimeve të huaja, por edhe të zhvillimit të bizneseve vendase.

Pas një pune disa mujore proaktive nga ana e skuadrës së MiSHMS dhe duke analizuar tregun aktual në Shqipëri e praktikat më të mira të rajonit dhe ato evropiane, është menduar rishikimi i ligjit të Dhomave të Tregtisë. Në thelb të tij qëndron unifikimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, si dhe gjithëpërfshirja e bizneseve në mënyrë që përfaqësimi dhe dialogu të jetë në nivelin e pritur.

Në këtë kuadër, shumë shpejt do të nisnin edhe konsultimet me grupet e interesit për ta bërë ligjin përfaqësues, i cili do të ketë vlerë të shtuar tek biznesi.

Mbështetje ndaj e-commerce, për t'iu ardhur në ndihmë bizneseve dhe start up-eve në vend

Në takim të zhvilluar me Ministres Bilali, Administratore të Postës Shqiptare dhe përfaqësues të kompanisë “Cloudcart”, u vuri theksi tek zhvillimi i mëtejshëm i e-commerce. I konsideruar si e “ardhmja e sotme” për Postën Shqiptare, e-commerce u vjen në ndihmë bizneseve dhe startup-eve që janë të përfshirë totalisht në këtë sektor.

Në këtë drejtim, MiSHMS dhe Posta Shqiptare do të mbështesin bashkërisht çdo iniciativë të mundshme, pasi digjitalizimi sjell shumë benefite duke filluar që nga ulja e kostove deri tek aksesimi ndaj tregjeve të reja.



<https://sipermarrja.gov.al/>



Edona Bilali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Shtator 2022

Inovacioni, sipërmarrja dhe të rinjtë, në qendër të projekteve të 7 bashkive fituese nga granti i MiSHMS.

Bashkitë Shkodër, Korçë, Pukë, Roskovec, Malësi e Madhe, Dimal dhe Burrel janë 7 nga bashkitë që kanë përfituar nga granti i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në Thirrjen e Parë. Inovacioni dhe sipërmarrja janë fokusi kryesor ku qendrat inovative, digjitale e teknologjike do të ofrojnë për të rinjtë e bashkive respektive fituese, por do të jenë të hapura edhe për të rinjtë e tjerë në mbarë vendin.

Një fond prej afro 50 milion lekësh do të alokohet pranë këtyre bashkive për krijimin e qendrave inovative, ku ndër të tjera do t'iu jepet mundësi grupmoshave të ndryshme, kryesisht adoleshentëve dhe të rinjve, që nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga lehtësues me përvojë në fushën e startup-eve të krijojnë prototipe dhe ide inovatore në zonë, gjë e cila do t'iu japë mundësi zhvillimi në një të ardhme të afërt.



Bashkia Malësi e Madhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

riNovo
RiNovo
Malësinë

ERDHI KOHA!

Nëse keni një ide biznesi,
nxitoni të aplikoni!

RINOVO MALËSINË

2022



4 universitete dhe 1 shkollë e mesme profesionale, pjesë e granteve fituese të kategorisë lehtësues nga grantet e MiSHMS

AKADEMI INOVACIONI

"Gjergj Canco"

Qëllimi i Akademisë

Nxitje dhe mbështetje e ideve sipërmarrëse dhe inovatore e të rinjve në fushën e teknologjisë.



#teknologji #inovacion #sipërmarrje #projekte #trajtime #start up

SHKOLLA
TEKNIKE
GJERGJ CANCO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTËR SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Nga krijimi i laboratorëve deri tek faza e planifikimit të ideve do të ofrohen nga akademina, e cila do t'iu garantojë nxënësve, studentëve dhe të gjithë rinjve mundësi pjesëmarrjeje dhe qasjen e duhur në tregun teknologjik dhe digjital. Plot 30 milion lekë do të lëvrohen nga granti i MiSHMS për akademinë nga thirrja e parë.

Një prej projekteve fituese është edhe "Akademi Inovacioni - nxitja dhe mbështetja e ideve sipërmarrëse të të rinjve", i cili do të zbatohet nga Shkolla Teknike Elektrike "Gjergj Canco", Tiranë. Nëpërmjet tij, synohet ngritja e një akademie të dedikuar ndaj ideve inovatore, motori i të cilave janë pikërisht nxënësit dhe komuniteti.



<https://sipermarrja.gov.al/>



Edona Bilali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Shtator 2022

Një destinacion tërheqës për nomadët digjitalë, Shqipëria synon të bëhet qendër e digjitalizimit dhe zhvillimit teknologjik

Mes datave 14-16 Shtator, është zhvilluar për herë të parë në Tiranë “Tirana Digital Nomad Festival”, i cili për tre ditë radhazi u kthye në pikëtakimin e ekspertëve digjitalë nga vende të ndryshme të botës. Ata ndanë përvojat e tyre me profesionistë, sipërmarrës dhe novatorë të rinj, të cilët aktualisht eksplorojnë botën e teknologjisë dhe punës në distancë.

E pranishme në këtë aktivitet, Ministria Bilali paraqiti një sërë nismash me rëndësi të ndërmarra në vendin tonë si: kodimi që në klasën e parë; mbështetja financiare për të rinjtë që duan të kualifikohen në TIK për tregun privat vendas; ligji i ri start up-eve dhe teknoparqeve; thjeshtimi i lejeve të qëndrimit apo digjitalizimi i 98% të shërbimeve etj.

Pavarësisht se në hapat e parë, ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe burimet që t'i japin ekosistemit një tjetër pamje: atë të zhvillimit teknologjik jo vetëm rajonal, por edhe evropian.



Mbështetje ndaj projektit "Startup Diaspora" në ndërtimin e marrëdhënieve të ngushta ndërmjet të rinjve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit

Në kuadër të Projektit “Startup Diaspora”, u zhvillua në ambientet e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes një takim me përfaqësues të start up-eve që veprojnë në diasporë.

Gjatë këtij takimi, u paraqit nga skuadra e MiSHMS një tablo e asaj çfarë ky institucion mbështet nëpërmjet Ligjit dhe Thirrjes duke krijuar qasje gjithëpërfshirëse në ekosistem, ku edhe ata vetë janë pjesë.

“Startup Diaspora” synon të ndërtojë marrëdhënie të ngushta ndërmjet të rinjve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, duke shkëmbyer ide dhe dije profesionale, si dhe duke nxitur interesin e tyre ndaj granteve të deritanishme. Kësisoj, ky do të jetë një angazhim i shtuar dhe kontribut për ekonominë shqiptare.



<https://sipermarrja.gov.al/>



Edona Bilali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Shtator 2022

Modeli inovativ “Quadruple Helix”, e ardhmja e gjeneratës së re

U zhvillua në Tiranë, Kongresi Kombëtar i Arsimit, me tematikë “Sfidat e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës të Shqipërisë 2030”.

Si pjesë e panelit “Kërkimi Shkencor dhe Inovacion”, Ministrja Bilali paraqiti sfidat dhe pritshmëritë që krijon bashkëpunimi mes universitetit, biznesit/industrisë, shoqërisë civile dhe institucioneve publike sipas modelit inovativ të “Quadruple Helix”, format dhe praktikat më të mira, të cilat janë edhe sfidat për të ardhmen.

Ndër arritjet e sotme janë edhe kurrikulat e integruara, ku shembull pozitiv ka dhënë Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës. Ndërkohë, ecuri pozitive dhe hapa konkretë shohim edhe në bashkëpunimin “Biznes-Arsimi i Mesëm Profesional”, i cili vjen si rezultat i qasjes proaktive të qeverisë shqiptare në bashkimin e këtyre dy sektorëve.



Shqipëria, një nga vendet më të sigurta për ngritjen e sipërmarrjeve

Në fokus të “Forumit Rajonal RISE”, zhvilluar në Tiranë mes datave 6-8 Shtator, ishin sipërmarrja dhe të rinjtë.

Në këtë aktivitet që mbledhi aktorët dhe palët më të rëndësishme të ekosistemit sipërmarrës nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa, u diskutua gjithashtu projekti i Inkubatorit Rajonal për Sipërmarrësit Socialë.

Si paneliste e vendit pritës, Ministrja Bilali pasqyroi një rezumë të përgjithshme të mjedisit të biznesit, iniciativave, arritjeve, por edhe sfidave të qeverisë shqiptare. Ndër të tjera, ajo nënvizoi faktin se vendi ynë është një nga vendet më të sigurta për ngritjen e sipërmarrjeve.



<https://sipermarrja.gov.al/>



Edona Bilali